



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETAR I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN --BUNE**

**LEJE**

**PER SHFRYTEZIM MATERIALESH INERTE NE SHTRATIN E LUMIT**

**Nr. 11, date 05.09.2012.**

**A - EMRI DHE ADRESA E MARRESIT TE LEJES**

Subjekti “ Salvatore Matarreze S.P.A.”, Administrator z. Claudio Salini, Rruga: Deshmoret e 4 Shkurtit” Tirane.

Kjo leje leshohet bazuar ne nenin 8, 20, 47 dhe 48 te ligjit nr.8093,date 21.03.1996”Per Rezervat Ujore”, si dhe vendimit te K.K.U.-se nr. 1 dt. 07.07.2011 “Per menaxhimin e shfrytezimit te zhavoreve per ndertimin e rrugeve”.

Qellimi i shfrytezimit te shtratit te lumit specifikohet ne paragrafin “C” te kesaj leje.

**B- OBJEKTI I LEJES DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE: Lumi KIR.**

Baseni Ujembledhes Drin – Bune, Qarku Shkoder, Komuna Guri Zi.

Shtrati i lumit eshte ne pronesi shtetere dhe zona e shfrytezimit ka keto specifikime:

Tabela e koordinatave :

X- 9- 4658050, 10- 4657940, 11- 4659800, 12- 4657700.

Y – 9- 4377460, 10- 4377520, 11- 4376070, 12- 4377070.

Z- 9- + 7.6, 10- + 7.1, 11- + 6.8, 12- + 6.7 .

Siperfaqja e shfrytezimit 0.14 km2, Volumi i materialit te nxjerrshem eshte 280.000 m3.

**C- AKTIVITETI PER TE CILEN DO TE PERDORET MATERJALI ESHTË:**

Shfrytezim materjale inertesh per mbushje trase rruge.

**E- KJO LEJE ESHTË E VLEFSHME DERI NE PERFUNDIM TE NDERTIMIT TE RRUGES SHKODER, KOPLIK.**

**KRYETARE**

**KESHILLIT TE BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

  
**Voltana ADEMI**  


Kjo leje leshohet bazuar ne ligjin nr. 8093,dt.21.03.1996,”Per rezervat ujore”,neni14. Qellimi i perdorimit te rezerves ujore specifikohet ne paragrafin D, te kesaj leje.

## **KJO LEJE SHFRYTËZIMI JEPET ME KËTO KUSHTE:**

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje.
2. Të respektohen kushtet higjeno-sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth.
3. Sipërfaqja e lejuar të shfrytëzohet nga drejtuesi i lejes. Leja ndalohet t'i transferohet një subjekti tjetër.
4. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejt ose si pasojë, dëmtimin e tokave bujqësore, veprave të artit.
5. Të mos pengohet kontrolli i shfrytëzimit të zonës, për të cilën është dhënë leja, që kryhet nga Agjencitë e Ujit të Këshillave të Baseneve Ujëmbledhës, nga Sekretariati Teknik i KJU, ose persona të autorizuar prej tyre.
6. Zotëruesi i lejes paguan 100 000 (njëqindmijë) lekë për shpenzimet administrative.
7. Subjekti që disponon këtë leje duhet të paraqesë në fund të çdo viti shfrytëzimi projektin e shfrytëzimit dhe rehabilitimit për vitin pasardhës.
8. Për shkeljen e kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa në përputhje me kreun XVI të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore".

## **NDRYSHIMI OSE ANULLIMI I LEJES:**

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht, para mbarimit të afatit të përcaktuar kur:

1. Përfituesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara më sipër.
2. Leja anulohet kur subjekti nuk paguan detyrimet financiare dhe nuk rakordon për to me Agjencinë e Ujit përkatëse brenda një afati kohor tre muaj.
3. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes pas azhornimitve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e zonës për nxjerrjen e materialit inert, konstaton shkelje për kushtet e vëna për të cilën është dhënë leja.
4. Kushtet e dhënies së lejes kanë ndryshuar.
5. Kur aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë, është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit.

**SHENIM : KJO LEJE SHFRYTEZIMI RINOVOHET CDO 3 VJET**

Për Agjencinë e Ujit

Për subjektin